

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË “3 UP” Sh.p.k.**

Sot, me datë 03/06/2020,

**Z. Eltjon Elezi**, shtetas Shqiptar, lindur më 24/08/1987, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse i pasaportës me nr:BR6243087, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " **“3 UP”** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është **“3 UP” Sh.p.k.**

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake nr.2, Rruga "Puntoret e Rilindjes", zonë kadastrale nr.8150, numër pasurie 6/534., Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Call Center. Lidhje telefonike brenda dhe jashtë vendit, biseda te ndryshme telefonike, Konsulence Biznesi, Contact Center.*

-*Import - eksport, tregti me shumice dhe pakice te materialeve,telekomunikacionit dhe te informatikes.*

- *Cdo aktivitet tjeter i cili nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.*

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 leke dhe është i ndarë në 1 kuote

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Eltjon Elezi** , zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 Leke dhe 100.000 Leke të kapitalit themeltar..

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm i shoqërisë është **Z. Eltjon Elezi**, shtetas Shqiptar, lindur më 24/08/1987, në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i pashaportes me nr BR6243087, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Eltjon Elezi**, shtetas Shqiptar, lindur më 24/08/1987, në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i pashaportes me nr.BR6243087, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**Eltjon Elezi**

